



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/234
Datë: 02.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të Qeverisë Nr. 11/226 të datës 23 tetor 2024

1. Plotësohet dhe ndryshohet vendimi i Qeverisë Nr. 11/226 i datës 23.10.2024 si në vijim:


Neni 6 pika 2 fshihet;

Neni 7 pika 4 fshihet;

Neni 7 pika 5 zëvendësohet me këtë tekst "Ekspertët e jashtëm për përzgjedhjen e projekteve duhet të jenë ekspertë të medias apo të OJQ-ve".

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë